



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 108/1 Prot

Tiranë, me 10 / 08 / 2015

Lënda: Jepet mendim

Drejtuar: Z.Shkëlqim CANI
MINISTËR I FINANCEVE

Për dijeni: Znj. Milena HARITO
MINISTËR I SHTETIT PËR INOVACIONIN
DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE

Tiranë

I Nderuar Z. Cani,

Në përgjigje të shkresës Nr.8673/3 Prot, datë 27.07.2015, nëpërmjet të cilës në lëndë kërkohet mendim për një projektvendim, paraprakisht sjellim në vëmendjen tuaj kontradiktën e konstatuar mes këtij fakti dhe përmbajtjes së shkresës. Ndërsa kërkohet mendim për një projektvendim, ky i fundit në përmbajtje të shkresës referohet i miratuar dhe konkretisht rezulton të jetë udhëzimi nr. 14 datë 13.05.2015 “Për disa shtesa në udhëzimin nr. 24, datë 02.09.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, akt i cili që prej muajit maj është botuar edhe në fletore zyrtare.

Në kushte të tilla vërejmë se është anashkaluar marrja e mendimit ligjor nga Zyra e Komisionerit në përputhje me parashikimin e bërë në nenin 31/1/“a” të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar në të cilin shprehimisht thuhet, 1) “Komisioneri është përgjegjës për a) dhënien e mendimeve për projekt-aktet, ligjore dhe nënligjore, që kanë të bëjnë me të dhënat personale, si dhe projektet që kërkohen të zbatohen nga kontrolluesit vetëm apo në bashkëpunim me të tjerë”.

Në vijim, sa i përket mbledhjes dhe përpunimit të të dhënës personale “numrit personal” (parashikuar për tu mbledhur në udhëzimin e lartpërmendur) të Letërnjoftimit ID për subjektet e të dhënave të cilët do të përfitojnë blerjen e dekoderave falas nga kontrolluesi Digitalb në kuadër të skemës së familjeve në nevojë, së pari hartuesi i ndryshimit ligjor duhet të ketë

vlerësuar mbledhjen e kësaj të dhëne në përputhje me qëllimin që do të realizojë, çka nënkupton përpunimin e të dhënave në mënyrë të drejtë, të ligjshme dhe proporcionale.

Nëse ligjërisht keni respektuar këtë përputhshmëri, në vijim kontrolluesi i përpunimit të kësaj të dhëne duhet që të kryejë njoftimin pranë Zyrës së Komisionerit, përpara se të nisë përpunimin e të dhënave, në përputhje me nenin 21 e në vijim të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar si dhe në vijim të procesit të respektojë parimet e parashikuara në nenin 5 të këtij ligji. Kjo nënkupton informimin e subjekteve mbi qëllimin e mbledhjes së numrit personal të ID, pasojës së shkaktuar në rast refuzimi të dhënies së kësaj të dhëne, mënyrën se si kjo e dhënë do të përpunohet, masat e sigurisë të përdorura për ruajtjen e saj, etj.

Si pjesë e rëndësishme e këtij procesi duhet konsideruar mbajtja e kësaj të dhëne deri në momentin e përfundimit të qëllimit për të cilin ajo është mbledhur dhe shkatërrimi i saj me mjete e mënyra ligjore të parashikuara nga kontrolluesi.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,



The image shows a circular official stamp of the IDPA (Instituti i Drejtësisë Personale) in Tirana. The stamp contains the text "REPUBLIKA E SHQIPËRI", "INSTITUTI I DREJTËSISË PERSONALE", "KOMISIONERI", and "TIRANA". Overlaid on the stamp is a handwritten signature in blue ink, which reads "Besnik Dervishi".